



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06
**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 9 nëntor 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Ndryshimin e Afateve në lidhje me Rishikimin e Shtatë të
Paraburgimit të z. Veseli**

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 39(1) dhe (13) dhe 41(10) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 9(5)(a) dhe (6) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 26 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi vendimin e gjashtë mbi rishikimin e rregullt të paraburgimit (“Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin”) të Kadri Veselit (“z. Veseli”), ku urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Veseli.² Në këtë vendim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ndër të tjera, urdhëroi Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) që, në rast se Mbrojtja nuk dorëzonte parashtrime, të dorëzonte parashtrime mbi rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Veseli deri më 31 tetor 2022, dhe Mbrojtjen e z. Veseli (“Mbrojtja”) të dorëzonte përgjigjen e saj deri më 10 nëntor 2022.³

2. Më 31 tetor 2022, ZPS-ja dorëzoi parashtrimet e veta mbi rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Veseli.⁴

3. Më 4 nëntor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbajti konferencën e pesëmbëdhjetë për ecurinë e çështjes.⁵ Gjatë kësaj konference për ecurinë e çështjes, Mbrojtja deklaroi se rishikimi i paraburgimit të z. Veseli nuk mund të

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00987, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit* (“Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin”), 26 shtator 2022, publik, para. 47(a).

³ Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin, para. 47(b)-(c).

⁴ KSC-BC-2020-06, F01069, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Kadri Veselit*, 31 tetor 2022, publike.

⁵ KSC-BC-2020-06, F01039, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Pesëmbëdhjetë për Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 17 tetor 2022, publik, para. 28(a); Transkripti i seancës, 4 nëntor 2022, publik.

bëhej deri në zgjidhjen e një problemi specifik në lidhje me nxjerrjen e materialeve (“problemi me nxjerrjen e materialeve”).⁶

4. Më 7 nëntor 2022, Mbrojtja njoftoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake në lidhje me qëllimin e z. Veseli për të hequr dorë nga e drejta për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të tij.⁷ Gjithashtu, Mbrojtja kërkoi që rishikimi i ardhshëm i paraburgimit të z. Veseli të shtyhej derisa të zgjidhej problemi me nxjerrjen e materialeve dhe parashtrioi që rishikimi i ardhshëm i paraburgimit të bëhej sa më shpejt që të ishte e mundur pas kësaj.⁸

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Sipas nenit 39(13) të Ligjit, kur është e nevojshme, me kërkesë të një pale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të lëshojë ndonjë urdhër tjetër që mund të jetë i nevojshëm për përgatitjen e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë.

6. Neni 41(10) i Ligjit dhe rregulla 57(2) e Rregullores parashikojnë se, deri në momentin që aktgjykimi merr formë të prerë ose deri në lirimin nga paraburgimi, me kalimin e dy (2) muajve nga vendimi i fundit për mbajtje në paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose paneli i ngarkuar me çështjen shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për paraburgim dhe lëshon vendim për vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.

7. Sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores, *proprio motu* ose nëse i tregohen arsye të vlefshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje ose prej panelit.

⁶ KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 4 nëntor 2022, konfidencial, f. 1617-1618.

⁷ KSC-BC-2020-06, F01091, Mbrojtësi i Specializuar, *Njoftim i Mbrojtjes së Veselit për Heqje Dorë nga Rishikimi i Paraburgimit* (“Njoftimi për Heqje Dorë”), 7 nëntor 2022, publik.

⁸ Njoftimi për Heqje Dorë, para. 1-2.

8. Sipas 9(6) të Rregullores, kur nuk i shkaktohet padrejtësi palës kundërshtuese, lejohet që vendimi në lidhje me një mocion për ndryshimin e afateve të merret duke mos i dhënë palës kundërshtuese mundësinë e shprehjes së mendimit.

III. DISKUTIM

9. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se në bazë të nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, paraburgimi i z. Veseli rishikohet çdo dy muaj. Duke marrë parasysh se Vendimi i Gjashtë mbi Paraburgimin u lëshua më 26 shtator 2022, rishikimi i ardhshëm i paraburgimit të z. Veseli duhet të bëhet, më së voni, më 25 nëntor 2022.

10. Duke pasur parasysh parashtrimet e Mbrojtjes të bëra në konferencën e fundit për ecurinë e çështjes lidhur me problemin me nxjerrjen e materialeve⁹ dhe njoftimin e z. Veseli në lidhje me qëllimin e tij për të hequr dorë nga e drejta për rishikimin e paraburgimit deri në zgjidhjen e problemit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekzistojnë arsye të vlefshme për ndryshimin e afatit të caktuar fillimisht në Vendimin e Gjashtë mbi Paraburgimin. Rrjedhimisht, pas zgjidhjes së problemit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në që, nëse dëshiron, të bëjë parashtrime shtesë për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Veseli në lidhje me zgjidhjen e problemit, deri të premtën 9 dhjetor 2022. Në vijim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron Mbrojtjen që, nëse dëshiron, t'u përgjigjet parashtrimeve të ZPS-së për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Veseli dhe parashtrimet të mundshëm shtesë në lidhje me zgjidhjen e problemit deri të mërkurën, 14 dhjetor 2022. Vendimi mbi rishikimin e paraburgimit të z. Veseli do të merret më pas, por jo më vonë se të hënën, 19 dhjetor 2022.

11. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron Mbrojtjen të dorëzojë, deri të premtën, 11 nëntor 2022, njoftimin e nënshkruar nga z. Veseli ku të

⁹ KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 4 nëntor 2022, konfidencial, f. 1591-1618.

konfirmojë se heq dorë nga e drejta për rishikimin e paraburgimit të tij përpara përfundimit të afatit dymujor të përcaktuar në nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores, dhe derisa të lëshohet vendim mbi rishikimin e paraburgimit të tij, deri të hënën, 19 dhjetor 2022.

12. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se ZPS-së nuk i shkaktohet padrejtësi nga lejimi i parashtrimeve në lidhje me problemin në kontekstin e rishikimit të ardhshëm të paraburgimit duke marrë parasysh se të dyja palëve do t'u jepet kohë e mjaftueshme për të paraqitur parashtrime për këtë problem dhe, si rrjedhojë, kërkesa për ndryshim të afateve në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit mund të pranohet pa i dhënë ZPS-së mundësinë e shprehjes së mendimit për këtë kërkesë.

IV. VENDIM

13. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- (a) **MIRATON** Kërkesën;
- (b) **SHTYN** rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Veseli deri të **hënën, 19 dhjetor 2022;**
- (c) **URDHËRON** Mbrojtjen të paraqesë njoftimin për heqje dorë nga z. Veseli, sikurse përcaktohet në paragrafin 11 më lart, deri **të premten, 11 nëntor 2022;**
- (d) **NDRYSHON** afatet për dorëzimin e parashtrimeve përcaktuar fillimisht në Vendimin e Gjashtë mbi Paraburgimin;
- (e) **URDHËRON** ZPS-në që, nëse dëshiron, të bëjë parashtrime shtesë në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Veseli, sikurse përcaktohet në paragrafin 10 më lart, jo më vonë se **të premten, 9 dhjetor 2022;** dhe

- (f) **URDHËRON** Mbrojtjen që, nëse dëshiron, t'u përgjigjet parashtrimeve të ZPS-së, dhe parashtrimeve të mundshme shtesë, jo më vonë se **të mërkurën, 14 dhjetor 2022.**

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E mërkurë, 9 nëntor 2022
Në Hagë, Holandë.